



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.163/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 3000 (*tremijë*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Me datën 10.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga organizata BIRN dhe Internews Kosova me të cilën pretendon se subjekti politik AAK, ka publikuar dhe shpërndarë një video promovuese të kandidatëve për kryetar të komunave, duke theksuar se në këto video - inqizime të fushatës zgjedhore janë përfshirë fëmijë të mitur. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 5.2 e Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësi të provës si dëshmi ankesës i ka bashkangjitur 2 video-inqizime.

Në përgjigje në ankesës të datës 11.10.2017, subjekti politik AAK, thekson se video-inqizimi është filmuar nga kompania e marketingut Zero Pozitiv, me të cilën jemi në mardhënje kontraktuale. Për më tepër ka theksuar se subjekti politik AAK, ka bërë përpjekje maksimale lidhur me përmbajtjen e ligjit dhe Kodit Zgjedhor, pasi që kjo video ka të bëjë lidhur me aspektin artistik dhe profesional.

Ka shtuar se subjekti politik AAK, ka pranuar njoftimin lidhur me ankesën dhe se e ka kontaktuar kompanin në fjalë, duke i kërkuar në mënyr urgjente të bëjë heqjen e sekuencave inqizuese ku paraqiten fëmijët. PZAP-it i ka kërkuar që të marrë për bazë veprimet e subjektit politik AAK lidhur me evitimin e shkeljes së supozuar, sepse të njëjtat veprime nuk janë bërë me qëllim të nxitjes së urrejtjes. Si dëshmi ka bashkangjitur videon e përmirësuar ku

është hequr promovimi i fushatës me fëmijë, kontratën me kompanin e marketingut në mes subjektit politik AAK dhe Zero Pozitive, nr.protok.18092017/1 i datës 18.09.2017.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga videot inqizuese të ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se subjekti politik AAK, me rastin fushatës zgjedhore përmes një video inqizimi të lansuar ka bërë fushatë me fëmijë të mitur, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkelur neni 5.2 I Rregullës Zgjedhore nr.13/2013, pasi që subjekti politik ka promovuar fushatë zgjedhore me fëmij të mitur, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik AAK në përgjigjen në ankes të datës 11.102017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik AAK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti subjekti politik AAK ka bërë fushat zgjedhore me fëmij të mitur . Po ashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë fshirë postimin e videos inqizuese si veprim i palejuar ku ka qenë i postuar ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv t këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL. Anr.163/2017 më datën 12.10.2017



**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.